



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:097406
Datë: 17.04.2024
Numri i dokumentit: 05585841

A.nr. 826/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Sh.B. - ... në adresën ..., kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, për shkak të anulimit të vendimit, jashtë seancës me datë 17.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PUSHOHET procedura sipas padisë së paditësit, ..., nën shenjën A.nr.1823/23 të datës 27.04.2023, për shkak të vdekjes së paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi, ..., ka ushtruar padi në këtë gjykatë, me datën 27.04.2023 kundër të paditurës, Ministria e Financave ,Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, me të cilën ka kërkuar “të aprovohet padia dhe kërkesë padia e tij si bazuar dhe të anulohet vendimi i MFPT Departamenti i pensioneve pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 21.03.2023, me të cilën është refuzuar ankesa e paditësit ... në kompensimin për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë.

Me datën 17.04.2023, ... e njofton gjykatën se paditësi ka vdekur me datën 11.06.2023, ku ka bashkëngjitur certifikatën vdekjes me numër V10603103 të datës 29 qershor 2023 me numër të referencës 1/2023RV/19001, e lëshuar nga Zyra Komunale e Gjendjen civile në Prishtinë, me të cilën vërtetohet se paditësi ka vdekur me datën 11.06.2023.

Me nenin 63 të Ligjit Nr.03-L/202 për Konfliktet Administrative, është përcaktuar që *“nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore”*

Gjykata i është referuar dispozitës së nenit 282 par. 1 të Ligjit Nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore i cili përcakton se *“Pushimi i gjykimit shkaktohet kur vdes pala, apo mbaron së ekzistuari po që se objekt i kontestit janë të drejtat që nuk mund të kalojnë në trashëgimtarët e palës përkatësisht në pasardhësin juridik të saj”*. Më tutje neni 102 paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 në të cilin përcaktohet *“nëse një person vdes gjatë procedurës administrative të nisur për një çështje kryekëput personale (intuitu personae), organi publik do ta mbyll dosjen dhe do ta përfundoj procedurën administrative”*.

Gjykata duke ju referuar këtyre dispozitave ligjore si dhe duke vlerësuar faktin se vendimi kontestues ka të bëjë me paditësin tani të ndjerin ..., nga ndërsa e drejta për njohjen e të drejtës në pension bazë të cilën paditësi e ka kërkuar përmes kësaj padie është një e drejtë personale (intuitu personae) dhe si e tillë ajo nuk mund të kalojë në trashëgimtar, andaj Gjykata e pushon procedurën sipas dispozitave në fuqi.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim të nenit 102 paragrafi 1 të LPA-së, nenit 282.1 të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.826/2023, datë 17.04.2024

G j y q t a r j a
Luljeta Maxhuni

Këshillë juridike: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njejtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.